



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

**Analizë**

# **PJESËMARRJA E GRAVE NË POLITIKË**



Ky publikim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e OJQ-së Sundimi i Demokracisë në Kosovë dhe jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

## Përmbajtja:

|                                                                               |    |
|-------------------------------------------------------------------------------|----|
| Akronimet: .....                                                              | 4  |
| 1.Përmbledhje ekzekutive .....                                                | 5  |
| 2.Analiza e Gjendjes .....                                                    | 6  |
| 2.1.Mjedisi politik, social dhe ekonomik për barazi gjinore .....             | 7  |
| 2.2. Fusha e Edukimit .....                                                   | 8  |
| 2.3. Fusha Ekonomike dhe Sociale .....                                        | 9  |
| 3.Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ) .....                                | 10 |
| 3.1. Vlerësimi i nivelit të informimit dhe pjesëmarrja .....                  | 13 |
| 4.Ndikimi i COVID-19.....                                                     | 14 |
| 5. Politikat dhe mekanizmat komunalë nga perspektiva e barazisë gjinore ..... | 15 |
| 6. Konkluzione:.....                                                          | 20 |
| 7. Rekomandime: .....                                                         | 21 |

## Akronimet:

ABGJ – Agjencia për Barazi Gjinore

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

BPGJ – Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor

KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

MAPL – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MFPT – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

RrGK – Rrjeti i Grave të Kosovës

## 1.Përmbledhje ekzekutive

Ky dokument analizon çështjen e barazisë gjinore nga një perspektivë më e gjerë e mekanizmave, politikave dhe financimeve në nivelin lokal/komunal. Duke përdorur një qasje holistike, është shtrirë në katër (4) dimensione kyçe: i. Analiza e gjendjes; ii. Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor; iii. Ndikimi i COVID – 19; iv. Politikat dhe mekanizmat komunalë nga perspektiva gjinore.

- i. **Analiza e gjendjes**, përfshihen tri segmente: mjedisi politik, fusha e edukimit dhe fusha ekonomike-sociale. Ku përshkruhen obligimet ligjore, analizohen statistika, të dhëna nga raportet dhe ekstrahohen informacione nga dokumente kredibile në këtë fushë. Duke përdorur qasje holistike, Në disa raste, kryqëzohen të dhënat për të ofruar një pasqyrë më të gjerë të problemit. E gjetura kryesore vendos në pah se përkundër që legjislacioni nxjerr disa detyra dhe obligime për komunat në këto segmente, megjithatë ndërthurja e politikave, proceseve dhe financimeve e kombinuar edhe me nivelin e ulët të kapaciteteve si dhe mungesën e praktikave të qëndrueshme, po e pengon zhvillimin koheziv. Për komunën propozohet një planifikimi i integruar i politikave dhe financimit në fokus barazinë gjinore.
- ii. **Buxhetimit i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ)**, trajtohen obligimet ligjore, nisur nga procesi i konsultimit e deri tek reflektimi në shtojcat e buxhetit. Krahason të dhëna, në mes planifikimeve dhe financimeve komunale, nga perspektiva e BPGJ. Si dhe qartëson konceptin e BPGJ, referuar organizatave të specializuara në këtë fushë. E gjetura kryesore në këtë segment ka të bëjë se përkundër që komuna ka përmbushur obligimin për hartuar dhe paraqitur shtojcën e BPGJ-së, mungesa e ndërthurjes me politikat, financimet sektoriale, nuk prodhon efektet e mjaftueshme. Propozohet që komuna të merr parasysh, buxheti sistematik sipas praktikave më të mira të BPGJ, të alokohet buxhet i mjaftueshëm për kryerjen e vlerësimit ex ante dhe ex post të ndikimit gjinor për të informuar të gjitha politikat, veprimet, dhe buxhetet sipas Ligjit për Barazinë Gjinore.
- iii. **Ndikimi i Covid – 19**, nxjerrën informata dhe të dhëna nga raportet, si dhe statistika nga pyetësorët me gratë. Në këtë dimension, duke ofruar rrjedhë paraqitet perceptimi i grave, lidhur me ndikimin e Covid-19, në sektorët ku ato punojnë. E gjetura kryesore është se për nga ndikimi Covid – 19, mund të konstatohet se ka thelluar edhe më shumë hendekun e pabarazisë, dhe se komuna nuk ka hartuar një program apo mbështetje të veçantë financiare. Rekomandohet vlerësimit ex post i ndikimit të Covid-19 dhe të propozohen qasje për të përmirësuar gjendjen.
- iv. **Politikat dhe mekanizmat komunalë nga perspektiva e barazisë gjinore**, reflektojnë të gjetura nga përmbushja e obligimeve ligjore karshi barazisë gjinore, pasqyrimin e trupave dhe mekanizmave komunalë në nivelin e përfaqësimit të dy gjinive, si dhe analizon strategjitë, politikat dhe rregullativën komunale, nga perspektiva e barazisë gjinore. Konstatimi i përgjithshëm është kryesisht ekziston një trajtimit formal ligjor, por që nuk është arritur deri tek një qasje e integruar e trajtimit të barazisë gjinore, nisur nga strategjitë, politikat zhvillimore, rregullativa, financimet e deri tek shërbimet administrative dhe publike komunale. Rekomandohet të hartohet plani i integruar për barazi gjinore si dhe kalendari i integruar për vendimmarrje.

Dokumenti në mënyrë të përmbledhur ofron një pamje të gjerë të sfidave, nevojave dhe perspektives së avancimit të barazisë gjinore në komunë. Merr parasysh ndërthurjen e problematikave dhe trajtimit në një dimension të gjerë të politikave, legjislacionit dhe mjedisit komunal. Nëpërmjet konkluzioneve paraqiten të përmbledhura çështjet kyçe të dala nga analiza, ndërsaq në rekomandime paraqitet harta e strukturuar e intervenimeve. Dokumenti do t'u shërbejë, akterëve lokalë, nisur nga hartimi i politikave, financimeve e deri tek përdorimi i një qasje më të integruar të trajtimit të barazisë gjinore.

## 2. Analiza e Gjendjes

Republika e Kosovës ka të miratuar Ligjin për Barazi Gjinore që garanton dhe promovon barazinë në mes gjinive<sup>1</sup>, por ende mbetet sfidues zbatimi i tij në praktikë. Edhe përkundër përpjekjeve institucionale, shoqërore, pabarazia mes grave dhe burrave shpërfaqet në shumë segmente. Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (2020-2024), thekson se 'faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë problem janë: mungesa e integritit gjinor në strategji dhe politikat zhvillimore; mos zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor; diskriminimi në punësim; niveli i ulët i shkollimit të grave në moshë pune (15-64); ndarja e profesioneve gjinore; ndarja e pabarabartë e obligimeve për përkujdesjen e fëmijëve dhe të moshuarve; pjesëmarrje e ulët e grave në menaxhimin e burimeve; mungesa e institucioneve për përkujdesjen e fëmijëve; dhe qasja e kufizuar në të drejtat pronësore dhe financa.'<sup>2</sup>

Kjo është akoma më e theksuar tek grupet më të nën-përfaqësuar duke përfshirë aspektet e ndërthurjes si vendndodhja gjeografike, mosha, aftësia e kufizuar, identiteti seksual, mes tjerash aspekte. Po në 'Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (2020-2024), tek analiza e gjendjes aktuale, theksohet se problemi kryesor për avancimin e barazisë gjinore qëndron te pabarazia dhe përjashtimi strukturor në arsim, shëndetësi dhe media, dhe mos shfrytëzimi adekuat i kapaciteteve njerëzore në fusha të ndryshme të jetës socio-kulturore dhe institucionale, ku që të gjitha e cenojnë arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm njerëzor'<sup>3</sup>. Në të shumtën e herëve, kjo vjen si rezultat i një kulture të trashëguar, të shtresëzuar edhe me mungesën e lirisë dhe demokracisë së konsoliduar. Si rrjedhojë, pamundësitë socio-ekonomike, kanë shtyrë që ky problem të shfaqet në forma të ndryshme, nisur nga mungesa e sigurisë në disa rrafsh (fizike, ekonomike, e punësimit, e pronës), e deri tek konceptet 'morale' shoqërore. Përkundër një progresi mund të konstatohet se ende mungon një mjedis i përshtatshëm, institucional dhe shoqëror që shtynë në transformim më të madh. Kjo, domosdo ka lidhje, shkak, pasojë, duke bërë që shoqëria të humbet një potencial të madh shoqërorë qoftë, institucional, ekonomik e social.

Nëse i referohemi qeverisjes lokale<sup>4</sup>, si adresa e parë ku qytetari ballafaqohet direkt me institucionin. Për nga rëndësia komuna llogaritet instrumenti kyç në ofrimin e shërbimeve dhe plotësimin e nevojave themelore, nisur nga ato bazike, uji i pijshëm, banimi, infrastruktura, edukimi, shëndetësia primare, e deri tek ato më të padukshme, por jo më pak të rëndësishme, si planifikimi i zhvillimit ekonomik, hapësinor e deri tek politikat sektoriale. Përkundër, legjislacionit dhe mekanizmave të avancuar që janë paraparë me legjislacion, strategji dhe dokumente, vërehen dy mangësi kryesore: e para, mungesa e qasjes strategjike dhe të integruar, dhe e dyta, mungesa e theksuar e kapaciteteve për zbatim. Tek, mungesa e qasjes strategjike dhe të integruar, mund të theksohet, qasja e fragmentuar e politikave dhe financimit në fushat që prekin familjes, e në veçanti promovimin e barazisë. Shpesh, shumë nisma të mira nuk marrin parasysh, e pengohen nga ndër-varësia e problemeve, për rrjedhojë nuk mund të sigurohet qëndrueshmëri. Ndërkaq, mungesa e kapaciteteve për zbatim dhe qasja formale ndaj problemeve, shpesh shtyn që problemet të mos kenë pasqyrim e gjerë dhe intervenimin e integruar për të prodhuar zgjidhje afatgjatë.

---

<sup>1</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

<sup>2</sup> <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ABGJ%20Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20p%C3%ABr%20Barazi%20Gjinore%202020-2024.pdf>

<sup>3</sup> Po aty

<sup>4</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2530>

## 2.1.Mjedisi politik, social dhe ekonomik për barazi gjinore

Referuar statistikave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), mund të konstatohet se përfaqësimi politik mbetet i ulët, në veçanti në pozitat udhëheqëse dhe vendimmarrëse. Përderisa, nga regjistrimi i



fundit i popullsisë, pothuajse struktura është e barabartë apo 50.8 (%) burra dhe 49.2 (%) gra<sup>5</sup>, kjo nuk reflektohet edhe në përfaqësim as politik, institucional, social dhe ekonomik, në veçanti në pozita vendimmarrëse. Sipas raportit të Institutit GAP, të vitit 2019, Punësimi dhe përfaqësimi i grave në Kosovë, në Komunën e Podujevës, në administratën komunale, nga 250 të punësuar, vetëm 73 janë gra, apo 29 (%), ndërkohë nga 22 pozita udhëheqëse, vetëm 4 janë gra apo 18 (%)<sup>6</sup>. Nga të dhënat në ueb faqen e Komunës, nga 13 pozita vendimmarrëse/ekzekutive (pozita politike), 4 janë gra (Nënkryetarja<sup>7</sup>

dhe dy drejtoresha, përkatësisht e Administratës<sup>8</sup>, Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë<sup>9</sup> dhe Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale<sup>10</sup>), apo 23.07 (%). Në garën për Kuvendin Komunal, kandidatë kanë qenë edhe dy (2) persona me aftësi të kufizuara<sup>11</sup> (1 grua dhe 1 burrë), megjithatë asnjëri nuk ka arritur të sigurojë votat e mjaftueshme.



**Nëntë (9) Burra, 69.23 (%)    Katër (4) Gra, 30.77 (%)**

Në Kuvendin Komunal, nga 35 këshilltarë komunalë<sup>12</sup>, 12 janë gra, apo **34.28 (%)**.

Nga 12 gra që përfaqësohen në Kuvendin Komunal:




**Dy (2) gra, 5.71 (%)** janë baresë liste;



**Pesë (5) gra, 14.28 (%)** kanë marrë mandat pa kuotë;



**Pesë (5) janë, 14.28 (%)** zgjedhur me kuotën gjinore 30 (%);



**Gra    Burra**  
**12    23**

Nëse i kalkulojmë brenda kuotës 30 (%); dymbëdhjetë (12) gra na del se 41.66 (%), kanë marrë mandatin në garë të barabartë me burrat. Nëse i llogarisim edhe dy (2) gra bartëse liste, del se 58.33 (%), kanë marrë vetë mandate dhe vetëm 41.66 (%) kanë marrë mandate përlllogaritur me kuotën 30 (%).

<sup>5</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive familjare 2011.

<sup>6</sup> 24031 Raporti Punësimi dhe përfaqësimi i grave në Kosovë 2019 final.pdf (institutigap.org)

<sup>7</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/staff/marigona-lahu/>

<sup>8</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/administrate/drejtore-i-administrates/>

<sup>9</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/drejtore-2/prone-kadaster-dhe-gjeodezi/drejtore/>


<sup>10</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/drejtore-2/shendetesi-dhe-mireqenje-sociale/drejtore-i-shendetesi/>

<sup>11</sup> <https://gazetainfokus.com/personat-me-aftesi-te-kufizuara-ne-garen-e-17-tetorit-flasin-per-sfidat-e-synimet-e-tyre/>

<sup>12</sup> KQZ certifikon rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve për 38 Kuvendet Komunale – KQZ (kqz-ks.org)

## 2.2. Fusha e Edukimit

Referuar të dhënave të ASK, për numrin e mësimdhënësve sipas përkatësisë gjinore, vitit (2020/2021), dhe



komuna, del se nga 1,157 mësimdhënës, 603 janë burra, apo 52.12 (%), dhe 554 gra, apo 47.88 (%). Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive familjare 2011, ku janë paraqitur të dhënat e popullsisë 6 deri 29 vjeç sipas gjinisë që ka qenë duke vijuar mësimin, del se diferenca më e madhe në mes të gjinive, mbetet tek shkolla e mesme e lartë (grada 10-13), ku nga 5909 nxënës, 3165 janë

djem apo 53.56 (%) ndërkaj, 2744 janë vajza apo 46.44 (%). Për dallim nga shkolla e mesme e ulët (grada 6-9), ku nga 6567 nxënës, 3335 janë djem apo 50.78 (%), ndërkaj 3232 janë vajza apo 49.21 (%). Ngjashëm, të dhënat qëndrojnë edhe për shkollimin fillor të ulët, përkatësisht 51.22 (%) djem dhe 48.78 (%) vajza. Pra, se diferenca më e madhe me 7.12 (%) përqindje shprehet tek, tek shkolla e mesme e lartë (grada 10-13). Kjo e dhënë, nëse krahasohet me statistikën e arsimit 2021/2022, del se numri i nxënësve në arsimin e mesëm të ulët, është 11359, nga ta 5825 djem apo 51.28 (%) dhe 5534 vajza apo 48.71%, ndërkaj në shkollimin e mesëm të lartë, nga totali 3643, djem janë 1877 apo 51.52 dhe vajza 48.47%.<sup>13</sup>. Këtu shihet, se diferenca është ulur nga 7.12 (%) në 3.05 (%), përderisa në shkollimin e mesëm të ulët është 2.57 (%).

### Popullsia e moshës 6 deri 29 vjeç që vijnë aktualisht shkollimin, sipas gjinisë, dhe moshës 2011

#### Meshkuj

#### Femra

|                                           |      |      |
|-------------------------------------------|------|------|
| Nuk ndjekin shkollën                      | 7759 | 7333 |
| Shkolla fillore (grada 1deri5)            | 5148 | 4901 |
| E mesme e ulët ( grada 6 deri 9)          | 3335 | 3232 |
| E mesme e lartë (grada 10 deri 13)        | 3165 | 2744 |
| Kolegji / universiteti (parauniversitar)  | 1591 | 1387 |
| Kolegji / universiteti (pasuniversitar)   | 194  | 123  |
| Kolegji / universiteti (doktoraturë / Dr) | 5    | 6    |

| Lista e përfituesve të bursës komunale për vitin akademik 2021-2022 <sup>14</sup> | Djem | %     | Vajza | %     |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------|-------|-------|-------|
| Totali i përfituesve të bursës 277                                                | 68   | 24.54 | 277   | 75.45 |

Për dallim nga bursat e ndara në vitin 2022, në vitin 2021 , ka përfshirë edhe shkollimin e mesëm të lartë (10-13).

| Lista e përfituesve të bursës komunale për vitin akademik 2020-2021 <sup>15</sup> | Djem | %     | Vajza | %     |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------|-------|-------|-------|
| Përfituesit e bursave për student                                                 | 16   | 27.58 | 42    | 72.42 |
| Përfituesit e bursave për shkollat e mesme (10-13)                                | 46   | 38.9  | 72    | 61.1  |

<sup>13</sup> <https://ask.rks-gov.net/media/6850/statistikat-e-arsimit-2021-2022.pdf>

<sup>14</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/07/Lista-e-perfituesve-te-burses-komunale-per-vitin-akademik-2021-2022.pdf>

<sup>15</sup> <https://www.llapi.info/publikohen-listat-perfituesve-te-bursave-ne-podujeve/>

### 2.3. Fusha Ekonomike dhe Sociale

Sipas të dhënave të ASK-së, popullsia e moshës mbi 15 vjeç, sipas statusit të aktivitetit aktual, ndarë në gjini del se, përderisa 17,085 burra janë ekonomikisht aktivë, numri i grave mbetet larg më i ulët apo 5,098, apo vetëm 29 (%) e numrit të burrave. Ngjashëm edhe tek numri i të punësuarve, ku përderisa burrat kanë deklaruar se të punësuar janë 9563, përderisa gratë vetëm 1627, apo 17.01 (%) krahasuar me burrat.

| Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual, sipas gjinisë 2011 |  | Meshkuj | Femra |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|--|---------|-------|
| Ekonomikisht aktive                                                                       |  | 17085   | 5098  |
| Të punësuar                                                                               |  | 9563    | 1627  |
| Të papunësuar, ka punuar më pare                                                          |  | 3498    | 312   |
| Të papunësuar, nuk kanë punuar kurrë më pare                                              |  | 3935    | 3100  |
| Të papunësuar, presin të fillojnë punën në të cilën janë pranuar                          |  | 89      | 59    |
| Ekonomikisht jo aktiv                                                                     |  | 14136   | 25372 |

Parë numrin e të punësuarve sipas veprimtarisë kryesore, nga **1624** gra, **1077** janë të përfshira në sektorët (arsim, shëndetësi, administratë, shërbime sociale dhe personale), apo **66.31(%)**, ndërsa 265 janë në tregti apo **15.76 (%)**. Ndarja e popullsisë sipas burimit kryesor të jetesës, gjinisë dhe komunës 2011, tregon se përderisa tek burrat puna (përfshirë punën në pronën, biznesin e tij apo të familjes) është 12436, tek gratë del se është 3707, apo **29.80 (%)**. Pra, përderisa tek kategoritë e përkrahjes institucionale është thuajse e barabartë, ndikimi ekonomik i pronës dhe bizneset familjare kryesisht u përket burrave. Edhe pse kategori e vogël, numri thuajse i barabartë është deklaruar tek patundshmëritë, investimet (qira, interes). Ndërkaq, mbështetja nga personat tjerë është **57 (%)** tek gratë, ndërsa **43 (%)** tek burrat.

| Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës, gjinisë dhe komunës 2011   |  | Meshkuj | Femra |
|------------------------------------------------------------------------|--|---------|-------|
| Puna (përfshirë punën në pronën, biznesin e tij apo të familjes)       |  | 12436   | 3707  |
| Patundshmëri, investime (qira, interes)                                |  | 195     | 177   |
| Pension                                                                |  | 2716    | 2451  |
| Ndihma sociale                                                         |  | 1741    | 1737  |
| Transfere tjera (përfitime nga papunësia, sëmundja dhe lehonie, bursë) |  | 99      | 88    |
| Remitenca (të ardhura nga familjarët në shtet tjerë)                   |  | 1601    | 1775  |
| Mbështetje nga persona tjerë                                           |  | 24216   | 31854 |
| Burime tjera                                                           |  | 1951    | 1755  |

Po nga të dhënat e ASK-së për personat e moshës 15 (vjeç) e mbi ekonomikisht jo aktive sipas kategorisë funksionale, gjinisë dhe komunës 2011, del se numri i personave që kujdesen për familjen është 16130, përderisa 15882, apo **98.46 (%)** janë gra dhe vetëm 248 burra, apo **1.54 (%)**. Tek gratë, barra e përkujdesjes ndaj familjes e në veçanti ndaj personave me aftësi të kufizuara, ka efekte multiplikative në çështjen e familjes. Numri i të punësuarve historikisht, është reflektuar edhe në dallimin gjinor të pensionuarve nga puna, ku nga 5167 në total, burra janë 2716, apo **52.56 (%)**, ndërsa gra 2451, apo **47.43 (%)**, këtu kryesisht pensione të moshës. Referuar statistikave të mirëqenies, korrik 2022, nga 50303 kontribut pagues që marrin pensione në nivel vendi, 41093 janë burra apo **81.69 (%)** dhe 9210 gra apo **18.31 (%)**<sup>16</sup>. Edhe tek numri i punëkërkuessve të regjistruar sipas komunave dhe gjinisë del se 3.603, janë (femra) dhe 2.748

<sup>16</sup> <https://ask.rks-gov.net/media/6974/statistikat-e-mireqenies-sociale-korrik-2022.pdf>


(meshkuj).<sup>17</sup> Tek statusi socio-ekonomik, problemi thellohet për gratë me aftësi të kufizuara sa i përket punësimit, në Raportin e MAPL-së theksohet se gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021, në 22 komuna, përfshirë Podujevën, janë të punësuar gjithsej 78 persona, 28 gra dhe 50 burra.<sup>18</sup> Në raportin e RrGK-së mbi politikat gjinore për personat me aftësi të kufizuara, rekomandohet të sigurohet që ligjet në këto fusha të përdorin një qasje ndërthurëse ndaj gjinisë, duke marrë përkatësinë etnike, moshën dhe faktorë të tjerë që mund të pengojnë qasjen në shërbimet e duhura të kujdesit<sup>19</sup>.

### 3. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ)

Sipas Qarkoreve të Buxhetit, të lëshuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), çdo organizatë buxhetore është e obliguar të dorëzojë shtojcën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, së bashku me kërkesat e tyre buxhetore<sup>20</sup>.

Në përputhje me Ligjin e ri Nr. 05/L-020 për barazinë gjinore, të gjitha organizatat buxhetore në Kosovë pritet të integrojnë BPGJ-në në proceset dhe dokumentet buxhetore, konkretisht, neni 3.1.17 i këtij ligji parasheh a përkufizimi për BPGJ i cili thotë si vijon: “Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor është zbatimi i integritit gjinor në procesin buxhetor. Kjo do të thotë vlerësim të buxheteve nga pikëpamja gjinore, në të gjitha nivelet e procesit buxhetor, dhe rristurimin e të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim të promovimit të barazisë për gra dhe burra.” Për më tepër, neni 5.1.5 obligon të gjitha institucionet që të integrojnë BPGJ-në, duke deklaruar se institucionet janë përgjegjëse për: “përfshirja e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si mjet i nevojshëm për të garantuar se parimi i barazisë gjinore respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe shpërndarjen e burimeve.”<sup>21</sup>

Konsultimet publike, janë mjet i rëndësishëm për BPGJ-në, në veçanti procesi i buxhetimit me pjesëmarrje<sup>22</sup> që i shërben rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin e financave publike. Në pyetjen e akëtës me gratë, referuar obligimeve të BPGJ dhe procesit të konsultimit ‘Sa shpesh keni marrë pjesë në diskutime, konsultime dhe procese publike?’, 38 (%) deklarojnë aspak, 24 (%) pak, 14 (%) mesatarisht, 17 (%) konsiderueshëm dhe 7 (%) plotësisht. Ndërkaq, në pyetjen që mat ‘gatishmërinë’ për kontribut dhe ngritur çështje në politika, procese dhe financime komunale, përgjigjet janë, 11 (%) aspak, 11 (%) pak, 32 (%) mesatarisht, 18 (%) konsiderueshëm dhe 28 (%) plotësisht.



<sup>17</sup> <https://ask.rks-gov.net/media/6927/buletini-tremujor-tm2-2022.pdf>

<sup>18</sup> <https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fmapl.rks-gov.net%2Fwp-content%2Fuploads%2F2022%2F04%2FRAPORTI-I-AKTIVITETEVE-TE-KOMUNAVE-NE-PROMOVIMIN-E-TE-DREJTAVE-TE-NJERIUT-JANAR-DHJETOR-2021.docx&wdOrigin=BROWSELINK>


<sup>19</sup> <https://womensnetwork.org/sq/rrgk-prezanton-rekomandimet-mbi-politikat-gjinore-per-personat-me-aftesi-te-kufizuara/>

<sup>20</sup> <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/6F628E4C-5DC8-4F3E-96FB-9135EB5665ED.pdf> Shtojca 1

<sup>21</sup> <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20170428114117535.pdf>

<sup>22</sup> <https://buxhetipjesemarrje.info/wp-content/uploads/2021/02/Udhezues-per-Buxhetimin-me-Pjesemarrje-Instrumenti-1.pdf>


Në pyetjen ‘Se cilat nga politikat komunale i vlerësoni më të rëndësishme për jetën e grave?’, vlerësimi më i lartë i është dhënë politikave të shëndetësisë 24 (%), e pasuar me një pikë më pak, edukimit 23 (%), politikat sociale dhe ato zhvillimore me nga 14 (%), politikat kulturore, rinore dhe sportive 9 (%) dhe me nga 8 (%)



politikat urbane, mjedisore dhe politikat infrastrukturore.

Dallimi mes urban dhe rural, veçohet në dy fusha, në urban 13 pikë e vlerësojnë politikat shëndetësore, përderisa në rural 5 pikë; politikat, urbane, mjedisore marrin pikë të barabarta, përderisa politikat e edukimit në rural marrin 9 pikë, në urban marrin 5 pikë. Dallimi vërehet mes rural dhe urban tek politikat në fushën kulturës, rinisë dhe sportit,

përderisa në urban marrin 2 pikë, në rural, trefishi, apo 6 pikë. Duke listuar, disa nga fushat e kompetencave komunale, janë pyetur gratë se cilat i vlerësojnë më të rëndësishme, në total prinë financimi i shërbimeve sociale, me 23 pikë, e pasuar nga financimi në fushën e bujqësisë dhe shëndetësisë dhe kujdesit me nga 20 pikë, fusha e edukimit dhe trajnimeve vlerësohet 18 pikë, me një pikë më pak 17, projektet në fushën e biznesit dhe zhvillimit ekonomik (agro-turizëm), 15 pikë, projekte në fushën e asistencës në shkrimin, menaxhimin e projekteve, 10 pikë fusha e rekreacionit dhe sportit si dhe vetëm 8 pikë projektet në fushën e banimit social.



Përderisa, Komuna e Podujevës, e ka përfshirë shtojcën për Buxhetim të Përgjegjshëm Gjinnor, në kuadrin e Buxhetit 2022<sup>23</sup>, mbeten një numër i madh politikash e financimesh sektoriale, që vlerësohen kyçe për pjesëmarrjen dhe konsultimin e grave. Nga akëta e kënaqshmërisë së qytetarëve, nxjerr nga DEMOS,

<sup>23</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/04/Buxheti-2022.pdf>

qershor 2022<sup>24</sup>, në pyetjen sa jeni të kënaqur me përcaktimin e prioriteteve të projekteve në buxhetin komunal?, 3.9 (%) deklarojnë deri diku i pakënaqur, 64.9 (%) deri diku i kënaqur dhe 31.2 (%) plotësisht i kënaqur. Ndërkaq, në pyetjen a keni informacione si ndahet buxheti i komunës, deklarimi i publikut është 25 (%) PO dhe 75 (%) JO.

Referuar shtojcës së BPGJ-së, në Buxhetin e vitit 2022 për numrin total të të punësuarve në shërbimin publik të komunës (administrata komunale, arsim, shëndetësi) është 1995 total. Nga këta 1102 apo 55.23 (%) janë burra dhe 893 apo 44.76 (%) janë apo kthyer në mjete financiare 7,166, 543.68 (€) dedikohen për të punësuarit burra dhe 5.353.465.32 (€), gra.

#### Ndërkaq, në vlerësimet e pagave në tri kategori:

|                |           |         |
|----------------|-----------|---------|
| 201 - 400 euro | 224 burra | 62 gra  |
| 400 – 600 euro | 821 burra | 780 gra |
| Mbi 600 euro   | 61 burra  | 47 gra  |

Në shtojcë e BPGJ sa i përket subvencionimeve, parashihen 1114 përfitues në total, gra 463 apo 41.56 (%), ndërkaq burra 651 apo 58.43 (%). Nga të dhënat e listave të përfituesve të subvencioneve në fushën e bujqësisë, del ndarja në përqindje e përfituesve gra dhe burra nuk është e barabartë dhe vetëm një rast kalon 30 (%), e nga listat e paraqitura në total rezulton 22.97 (%). Kjo tregon, se edhe si pasojë e indikatorëve më lartë edukimit, pronave, bizneseve, numri i grave përfituese është dhe mbetet i ulët.

| Subvencioni                                                                                                       | Data e publikimit | Totali i përfituesve | Gra        | %            | Burra      | %            |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|----------------------|------------|--------------|------------|--------------|
| Përfituesve të subvencionit (serra) <sup>25</sup>                                                                 | 22.07.2022        | 152                  | 40         | 26.32        | 112        | 73.68        |
| Shoqëri bletësh <sup>26</sup>                                                                                     | 08.04.2022        | 140                  | 25         | 17.86        | 115        | 82.14        |
| Përfitues të subvencionit (fidanë të mjedres) <sup>27</sup>                                                       | 04.03.2022        | 40                   | 7          | 17.5         | 33         | 82.5         |
| Përfitues të subvencionit, (mëshqerra) <sup>28</sup>                                                              | 24.12.2021        | 45                   | 6          | 13.33        | 39         | 86.67        |
| Përfitues të subvencionimit (dele, kosë, frezë, lopë qumështore, kultivator me pajisje përcjellëse) <sup>29</sup> | 14.12.2021        | 44                   | 5          | 11.36        | 39         | 88.63        |
| Përfitues të subvencionit, (mëshqerra) <sup>30</sup>                                                              | 16.06.2021        | 70                   | 7          | 10           | 63         | 90           |
| Përfituesve të subvencionit (serra) <sup>31</sup>                                                                 | 30.04.2021        | 250                  | 75         | 30           | 175        | 70           |
| Përfitues të subvencionit (fidanë të mjedres) <sup>32</sup>                                                       | 01.04.2021        | 47                   | 16         | 35.05        | 31         | 65.95        |
| <b>Total</b>                                                                                                      |                   | <b>788</b>           | <b>181</b> | <b>22.97</b> | <b>607</b> | <b>77.03</b> |

<sup>24</sup> [http://helvetas-ks.org/demos/wp-content/uploads/2022/07/CSS\\_Alb\\_FINAL.pdf](http://helvetas-ks.org/demos/wp-content/uploads/2022/07/CSS_Alb_FINAL.pdf)

<sup>25</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/07/Lista-e-perfituesve-te-serrave.pdf>

<sup>26</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/04/Lista-e-perfituesve-per-shoqeri-bletesh.pdf>

<sup>27</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/03/Lista-e-perfituesve-ne-projektin-furnizimi-me-fidane.pdf>

<sup>28</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2021/12/Lista-e-perfituesve-per-meshqerra.pdf>

<sup>29</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2021/12/Lista-e-perfituesve-Organizata-QATAR-CHARITY.pdf>


<sup>30</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2021/06/Lista-Meshqerra-2021.pdf>

<sup>31</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2021/04/Perfituesit-serrat-2021.pdf>

<sup>32</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2021/04/Lista-e-te-perzgjedhurve-ne-projektin-Furnizimi-i-fermereve-me-fidane-te-mjedrave.pdf>

### 3.1. Vlerësimi i nivelit të informimit dhe pjesëmarrja

Të dhënat janë kryqëzuar me pyetësin e shtrirë në dy dimensione: informimi, dhe pjesëmarrja në politik bërje/vendimmarrje;. Të dhënat e nxjerra tregojnë se informimi për politikën ka korrelacion të drejtë me nivelin e pjesëmarrjes. Përderisa në pyetjen ‘Sa jeni të informuar për politikën dhe financimet komunale?’,



gratë janë përgjigjur, 52 (%) aspak dhe pak, (30% aspak; pak 22%), 26 (%) mesatarisht dhe me nga 11 (%), konsiderueshëm dhe plotësisht. Në këtë të dhënë kemi nxjerrë dallimin mes informimit në vendbanimet urbane dhe rurale. Në rural, vlerësojnë se janë të informuar 43 (%) aspak, 43 (%) pak dhe 14 (%) mesatarisht. Përderisa në urban, vlerësojnë 60 (%) mesatarisht, 20 (%) pak dhe 20 (%) aspak. Në grupimin e parë (1) sipas punës/profesionit (mësimdhënëse, menaxhere biznesi, student, juriste,

arti/kultura), del se 12 (%), konsiderojnë aspak, 25 (%), pak, 37 (%), mesatarisht, 13 (%), konsiderueshëm dhe 13 (%), plotësisht. Ndërkaq në grupimin dytë (2), (amvisë, blerëtorë, pastiqeri, rrobaqepëse, hotelieri, prodhim) del, se 26 (%), konsiderojnë aspak, 32 (%) pak, 21 (%), mesatarisht, 10 (%), konsiderueshëm dhe 11 (%), plotësisht. Mund të konstatohet se dallimi në mes profesioneve sa i përket informimit për politikën dhe financimet komunale, mbetet i përafërt.


Dallimi ndodh edhe në format e informimit, përderisa në total prin 25 (%) (media, TV dhe radio), 19 (%) ueb faqja e komunës; rrjetet sociale që përdor komuna, 24 (%), faqet/rrjetet sociale tjera 8 (%), nga shoqëria civile 8 (%), pjesëmarrja direkte në diskutime 2 (%) dhe 12 (%) njëpërmjet familjes dhe miqve. Përderisa në pyetjen referuar obligimeve të organizatave buxhetore për konsultime publike; Ligjit për Barazi Gjinore dhe rregullativës në këto fusha ‘Sa e vlerësoni nivelin e pjesëmarrjes tuaj, në politikën, proceset dhe diskutime për buxhetin?’ 32 (%) janë përgjigjur aspak; 26 (%) pak; 29 (%) mesatarisht; 3 (%) konsiderueshëm dhe 10 (%) mesatarisht.

Tek forma e informimit mes rural dhe urban nuk vërehet dallim ku në urban, 20 (%) deklarojnë nga mediat (TV dhe radio); 22 (%) nga ueb faqja e komunës; 20 (%) rrjetet sociale që përdor komuna; 13 (%) faqet tjera sociale; 11 (%) nga shoqëria civile; 3 (%) direkt nga pjesëmarrja në diskutime dhe 11 (%) njëpërmjet familjes dhe miqve. Përderisa në rural, 20 (%) nga mediat (TV dhe radio); 20 (%) nga faqja zyrtare e komunës; 27 (%) rrjetet sociale që përdor komuna; 11 (%) faqet tjera sociale; 9 (%) shoqëria civile; 3 (%) pjesëmarrja direkt në diskutime dhe 12 (%) nga familja dhe miqtë.

Në pyetjen ‘Sa e vlerësoni të mjaftueshëm informimin për politikën, proceset dhe financimet komunale?, del se aspak mendojnë, 16 (%), pak 39 (%), mesatarisht, 29 (%), konsiderueshëm 10 (%) dhe plotësisht 6 (%). Ndërkaq, në pyetjen ‘Sa e vlerësoni se përfaqësohen interesat e grave në politikën dhe financimet komunale?’, 20 (%) vlerësojnë aspak, 15 (%) pak, 38 (%) mesatarisht, 12 (%) konsiderueshëm dhe 15 (%) plotësisht.

## 4.Ndikimi i COVID-19

Hendeku i mos barazisë dhe vështirësitë ekonomike janë rritur edhe si pasojë e mbylljes dhe pandemisë.



Në hulumtimin 'Pandemia nuk njeh gjini' nxjerrë nga Rrjeti i Grave të Kosovës, konstatohet se si rezultat i mbylljes dhe masave të izolimit, gratë kanë mbajtur barrën e shtuar të punës së papaguar të kujdesit, siç janë kujdesi për fëmijët, për të moshuarit dhe për punë të tjera shtëpiake. Përgjegjësitë e rritura kanë pasur ndikime negative në mirëqenien fizike dhe mendore të grave.<sup>33</sup> Referuar raportit të MAPL-

së, ndikimet socio-ekonomike të COVID – 19 në Komunat e Kosovës, tek Mjedisi i Biznesit, theksohet se në vitin 2020 – 2021, janë mbyllur nëntë biznese të drejtuara nga gratë, kryesisht në sektorët e tekstilit, shërbimeve dhe prodhimit ushqimor.<sup>34</sup> Po ky raport, tek fusha tregu i punës, sipas vlerësimeve nga zyrtarët komunal, nxjerr në pah se sektorët që janë prekur më së shumti sipas shkallës së punësimit, ka prekur rreth -33 00 (%), gratë dhe të rinjtë. Në pyetjen 'sa ka ndikuar COVID – 19, në sektorin ku punoni?', 45 (%), e grave vlerësojnë plotësisht, 10 (%), konsiderueshëm, 14 (%), mesatarisht, 14 (%) pak dhe 17 (%) aspak.

Përderisa Komuna e Podujevës, nuk listohen në mesin e 8 komunave (Gjilan, Vushtrri, Ferizaj, Gjakovë, Skenderaj, Rahovec, Junik, Kamenicë) që kanë ndarë mjete financiare për subvencionimin e bizneseve gjatë kohës së pandemisë COVID-19.<sup>35</sup> Dy komuna (Podujeva, Lipjani) miratuan masa të pjesshme ekonomike, siç janë përjashtimi i bizneseve nga taksat komunale.<sup>36</sup> Në pyetjen 'A keni marrë ndonjë lloj të përkrahjes nga shteti nga Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike?', nga 35 (%) gra, vetëm nëntë (9) kanë deklaruar se kanë përfituar pesë (5), subvencion të pagës; dy (2), pagesë shtesë sociale; dhe dy (2) tjerët, përfitues të shtesave për student, sipas vendimit të qeverisë 10/69, për masat e shtimit e mbështetjes për qytetarët e Republikës së Kosovës, në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike<sup>37</sup>. Komuna e Podujevës në vitin 2021, përkundër pandemisë, është në mesin e 18-të komunave që ka raportuar takimeve, trajnimeve, fushatave ndërgjegjëse në mbrojtje nga diskriminimi.<sup>38</sup>

<sup>33</sup> [https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/12/RrGK\\_Pandemia-nuk-njeh-gjini.pdf](https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/12/RrGK_Pandemia-nuk-njeh-gjini.pdf)

<sup>34</sup> Raporti Ndikimet Socio-Ekonomike të COVID – 19 në Komunat e Kosovës, MAPL, 2022, faqe 102

<sup>35</sup> <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/03/Raporti-pe%CC%88r-pe%CC%88rmbushjen-e-obligimeve-te%CC%88-komunave-nga-Agienda-Evropian-Janar-Dhjetor-2021.pdf>

<sup>36</sup> [https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/12/RrGK\\_Pandemia-nuk-njeh-gjini.pdf](https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/12/RrGK_Pandemia-nuk-njeh-gjini.pdf)

<sup>37</sup> <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Vendimet-e-mbledhjes-se-69-te-te-Qeverise-1.pdf>

<sup>38</sup> <https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fmapl.rks-gov.net%2Fwp-content%2Fuploads%2F2022%2F04%2FRAPORTI-I-AKTIVITETEVE-TE-KOMUNAVE-NE-PROMOVIMIN-E-TE-DREJTAVE-TE-NJERIUT-JANAR-DHJETOR-2021.docx&wdOrigin=BROWSELINK>

## 5. Politikat dhe mekanizmat komunalë nga perspektiva e barazisë gjinore

Referuar Raportit të Përbushjes së Obligimeve nga Agjenda Evropiane (Janar – Dhjetor 2021); Raportit të Performancës së Komunave (2020) nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mund të konstatohet se kërkohen përkushtim dhe rezultate konkrete në përbushjen e këtyre obligimeve. Të dhënat e raportit të performancës së komunave 2020, të ekstraktuara për Komunën e Podujevës, në vlerësimin e indikatorëve të barazisë gjinore vlerësohen me 31.10 pikë, nga 100 në total, apo 3.78 pikë më ulët se mesatarja e komunave që është 34.88 pikë. Në veçanti, sikurse në Komunën e Podujevës, mesatarja bie nga dy faktorë: e para barazia tek anëtarët e komiteteve komunale, në veçanti atyre sektoriale dhe tek barazia në këshillat lokalë. Përderisa, tek dy komitetet e përhershme (politikë, financa dhe komitetet), është arritur të sigurohet barazia gjinore 50/50.

Ndërkaq, raporti Përbushja e Obligimeve nga Agjenda Evropiane (Janar – Dhjetor 2021), nxjerr këto detyra dhe obligime specifike për Komunën e Podujevës: Të hartohet Strategjia kundër dhunës në familje; Të caktohet zyrtari për mbrojtjen nga diskriminimi, ku komunat janë të obliguara të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.<sup>39</sup> Të themelohet këshilli komunal për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në baza gjinore; Të organizohen fushata për shëndetin e nënës dhe fëmijës.

### Dokumentet Strategjike

Për të vlerësuar nivelin e barazisë gjinore dhe qasjen afirmative janë analizuar dokumentet kyçe komunale si Plani Zhvillimor Komunal, Strategjia për Zhvillim Ekonomik, Rregulloret dhe Vendimet. Referuar këtyre të dhënave, del se Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) 2016-2025<sup>40</sup>, në nivel të analizës së gjendjes tek pika 1.4. çështjet sociale, specifikisht 1.4.6. nxjerr disa të dhëna për përfaqësimin e grave, megjithatë në nivel të objektivave strategjike, e as veprimeve, nuk parasheh ndonjë masë specifike. Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal (2020-2022)<sup>41</sup>, tek vlerat, vizion dhe misioni, në një nga parimet thekson eliminimin e pabarazive, duke promovuar drejtë si dhe mundësi. Këtu, pabarazitë, nuk ka referencë specifike gjinore. Ndërkaq, Strategjia për Zhvillimin e Turizmit (2019-2021), përdor referencë, tek aktivitetet kulturore në Komunën e Podujevës, saktësisht, Panairi i Shoqatës së Grave “ANTIKA”.

### Rregullativa Komunale:

Në nivel të rregullativës komunale, nga katër (4) rregullore të analizuara, në dy nuk ka asnjë referencë për barazi gjinore (rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore<sup>42</sup>; draft – rregullorja për taksa, tarifa dhe gjoba komunale<sup>43</sup>). Ndërkaq, dy (2), rregullore: ajo për Themelimin e Këshillave të Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane<sup>44</sup>, dhe ajo për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve<sup>45</sup>, kanë këto referenca për barazi gjinore.

<sup>39</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>

<sup>40</sup> [https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2020/11/PZHK-Podujeve\\_FINAL.pdf](https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2020/11/PZHK-Podujeve_FINAL.pdf)

<sup>41</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2020/11/1.1.SZHELPlani-2020-2022-1.pdf>

<sup>42</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/07/Rregullore-per-funksionimin-e-institucioneve-arsimore.pdf>

<sup>43</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/05/Vendimi-per-venie-ne-diskutim-publik-propozim-rregulloren-per-teksa-tarifa-dhe-gjoba-komunale.pdf>

<sup>44</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/05/Vendimi-per-venie-ne-diskutim-publik-propozim-rregulloren-per-teksa-tarifa-dhe-gjoba-komunale.pdf>

<sup>44</sup> [Vend-per-venie-ne-diskutim-publik-draft-Rreg-per-bashkepunim-me-fshatra-lagje-urbane.pdf \(rks-gov.net\)](https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/06/Rregullore-per-kushtet-kriteret-dhe-procedurate-ndarjes-se-Subvencioneve.pdf)

<sup>45</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/06/Rregullore-per-kushtet-kriteret-dhe-procedurate-ndarjes-se-Subvencioneve.pdf>

- *Draft - Rregullorja për Themelimin e Këshillave të Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane, tek neni 5. Përbërja e këshillave lokalë dhe kriteret e përzgjedhjes, tek pika 13. Tubimet kanë legjitimitet nëse në tubim janë së paku 31 pjesëmarrës me të drejtë vote, duke respektuar Ligjin për Barazi Gjinore.*
- *Rregullorja për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve tek neni 18, kriteret e përgjithshme, pika 5. Bizneset dhe idetë e bizneseve të cilat udhëhiqen nga gratë dhe të rinjtë.*

### Trupat e Kuvendit Komunal

Me vendosjen e fokusit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), për përfaqësim të barabartë sa i përket komiteteve brenda Kuvendeve Komunale, vetëm 6 nga 38 komuna, nuk u janë përmbajtur kërkesave për barazi gjinore<sup>46</sup>. Përderisa, Komuna e Podujevës, në muajin Qershor 2022, ka themeluar edhe tri komitete tjera të kuvendit (barazi gjinore; zhvillim ekonomik lokal dhe shëndetësi dhe mirëqenie sociale).

| <b><i>Përfaqësimi në trupa dhe mekanizma të Kuvendit Komunal sipas gjinisë</i></b>                          | <b><i>Gra</i></b> | <b><i>Burra</i></b> |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|---------------------|
| <i>Komiteti për Barazi Gjinore<sup>47</sup></i>                                                             | 3                 | 2                   |
| <i>Komiteti për Zhvillim Ekonomik<sup>48</sup>,</i>                                                         | 2                 | 3                   |
| <i>Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale<sup>49</sup></i>                                           | 2                 | 3                   |
| <i>Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS<sup>50</sup>),</i>                                         | 2                 | 16                  |
| <i>Komision ad-hoc për hartimin e draft – rregullores për orarin e punës së bizneseve<sup>51</sup></i>      | 2                 | 7                   |
| <i>Komisioni i Kuvendit për hartimin e planit të punës (2022)<sup>52</sup>,</i>                             | 4                 | 5                   |
| <i>Përfaqësimit të Komunës së Podujevës, në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës<sup>53</sup></i> | 1                 | 4                   |

| <b><i>Komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Komunale sipas gjinisë</i></b> | <b><i>Gra</i></b> | <b><i>Burra</i></b> |
|---------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|---------------------|
| <i>Komisioni i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike të Banim<sup>54</sup></i>          | 1                 | 2                   |
| <i>Komisioni i Aksionarëve të Stacionit të Autobusëve<sup>55</sup></i>                |                   | 3                   |
| <i>Komisioni i Aksionarëve KRM Pastrimit<sup>56</sup></i>                             | 2                 | 1                   |

<sup>46</sup> [http://www.kipred.org/repository/docs/Analyze\\_Gjinore\\_PKZMSA\\_171017.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/Analyze_Gjinore_PKZMSA_171017.pdf)

<sup>47</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/07/Vendim-per-themelimin-dhe-perberjen-e-Komitetit-per-Barazi-Gjinore.pdf>

<sup>48</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/07/Vendim-per-themelimin-dhe-perberjen-e-Komitetit-per-Zhvillim-Ekonomik-.pdf>

<sup>49</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/07/Vendim-per-themelimin-dhe-perberjen-e-Komitetit-per-Shend.-dhe-Mireqenie-Sociale.pdf>

<sup>50</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/05/Vendimi-per-themelimin-dhe-perberjen-e-KKS.pdf>

<sup>51</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/07/Vendim-per-ngritjen-e-komisionit-per-hartimin-e-draft-Rreg-per-orarin-e-punes-se-bizneseve.pdf>

<sup>52</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/01/Vendim-per-Themelimin-dhe-perberjen-e-KPF-se.pdf>

<sup>53</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/03/12.Vendim-per-perfaqesim-ne-Asociacionin-e-Komunave-te-Kosoves.pdf>

<sup>54</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/03/Komisioni-Komunal-i-NP-per-Banim.pdf>

<sup>55</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/03/Komisioni-Komunal-i-NP-Stacioni-i-Autobuseve.pdf>


<sup>56</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/03/Komisioni-Komunal-i-KRM-Pastrimi.pdf>

## Mbledhjet e Kuvendit Komunal (2022)

Në dhjetë (10) procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit Komuna, në vetëm katër (4) raste, referohet barazia gjinore (gratë, vajzat dhe grupi jo formal i grave):

- Mbledhja solemne të datës 17 shkurt 2022,<sup>57</sup>ku në kontekstin historik në fjalën e tij Kryetari i Komunës referohet ‘Gjithmonë, e në raste të veçanta siç është përvjetori i pavarësisë, kujtojmë më nder, të gjithë gratë dhe burrat, që në vështirësitë e kohërave, e në rrethana të ndryshme historike kontribuuan që vendi ynë ta gëzoj këtë ditë’;
- Mbledhja e rregullt të mbajtur më 28 shkurt 2022<sup>58</sup>, tek pika të ndryshme ‘znj. Drita Pajaziti, theksoi “më lejoni që në këtë pikë të propozoj që ne gratë e Kuvendit të Komunës së Podujevës ta formojmë Grupin Joformal të Grave Asambliste dhe për këtë ftoj grat që janë pjesë e këtij Kuvendi që ta mbajmë një takim të premtën në ora 12;00 këtu në Komunë”;
- Mbledhja e rregullt të mbajtur më 29 prill 2022<sup>59</sup> ‘Kryesuesi i Kuvendit, theksoi “ne duhet të kemi kujdes sa i përket anëtarëve të Komiteteve nga radhët e komuniteteve sepse në këtë Komitet shumica e anëtarëve duhet të jenë nga komunitetet jo shumicë, gjithashtu duhet të përcaktohet edhe kuota gjinore”;
- Mbledhjen e rregullt të mbajtur më 29 prill 2022<sup>60</sup>, tek diskutimi për rregulloren për kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve, Këshilltari Gazmend Islami referohet “Nuk është mirë të personalizohen këto gjëra, mirëpo unë mendoj se është diskriminim nëse mendojmë, shembull të favorizojmë një X Klub të futbollit, mandej ta marrim Volejbollin për të cilin duhet të jemi krenar që ka arritur t’i ketë në Klub së paku 100 femra/vajza të reja dhe të shkëlqyera të cilat kanë arritur të hyjnë në Super ligen e Kosovës”.

Nga vlerësimet e anketës për mekanizmat, instrumentet dhe nevojën për kapacitete nga të dhënat e gjeneruara del se në pyetjen ‘Cili mendoni se është meknizmi kryesorë ku gratë mund ti adresojnë problemet e tyre?’, Zyra për Barazi Gjinore, ka mbledhur 22.35 pikë, e pasuar pas nga Kuvendi Komunal me



<sup>57</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/05/Proc.Kuv.-17.02.2022-solemne.pdf>


<sup>58</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/05/Proc.Kuv.-28.02.2022.pdf>

<sup>59</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/08/Proc.Kuv.-29.04.2022.pdf>

<sup>60</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/08/Proc.Kuv.-29.04.2022.pdf>

20 pikë, 14.12 pikë besojnë në këshillat e fshatrave dhe lagjeve urbane; 9.41 institucionet fetare, 8.24 pikë, media, 7.06 pikë, shoqëria civile dhe 5.88 pikë ekzekutivi komunal.


Përderisa, në pyetjen ‘Si e vlerësoni nivelin e përfaqësimit të grave në trupat komunalë?’, më së shumti pikë ka marrë ekzekutivi me 90 pikë, i pasuar nga Kuvendi Komunal, me 67 pikë, sektori i arsimit 64 pikë, shëndetësisë 60 pikë, grupi joformal i grave 53 pikë, administrata komunale 47 pikë, ndërmarrjet publike komunale 42 pikë, komitetet konsultative (profesionale) 45 pikë, Këshillat e Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane 38 pikë, komitetet tjera (sektoriale) 34 pikë. Kjo tabelë, reflekton mungesën e njohjes së Ligjit për Barazi Gjinore dhe njohjen e mekanizmave dhe përfaqësimin real të grave. Nga anketa e kënaqshmërisë së qytetarëve, nxjerr nga DEMOS, qershor 2022, në pyetjen, a mendoni se komuna juaj u ofron grave mundësi të barabarta, për pozita udhëheqëse (arsim, shëndetësi, institucione kulturore dhe pozita politike në komunë)?, del se 1.6 (%), mendojnë aspak, 24.7 (%) shumë pak, 62.5 (%) disi, 10.6 (%) në masë të madhe dhe 0.6 (%) refuzojnë të përgjigjen.




Përderisa gratë, vlerësojnë se instrumenti kyç i politikave, në adresimin e problemeve, kërkesave dhe nevojave, është procesi i hartimit të akteve dhe rregullativës komunale, me 21 pikë, hartimi i politikave financiare (buxheti dhe korniza afat-mesme buxhetore), me 15 pikë dhe hartimi i dokumenteve zhvillimore dhe strategjive me 12 pikë hartimi i akteve dhe rregullarivës komunale.

Një segment i veçantë i trajtimit ka qenë edhe nevoja për kapacitete, ku në pyetjen ‘Në cilat fusha ekziston nevoja më imediate për kapacitete dhe mbështetje?’, në këtë pyetje, me 13 pikë është

vlerësuar, njohja me legjisllacionin primar dhe sekondar, 12 pikë, kapacitete në paraqitje publike, adresim dhe avokim të çështjeve publike, 11 pikë kapacitete në identifikim, analizë, krahasim të hartimit të



politikave/strategjive, 9 pikë në avancimin e praktikave dhe modeleve dhe 8 pikë, kapacitete në fushën e financave dhe politikave sektoriale.



## 6. Konkluzione:

- Përkundër se ekziston një bazë solide e legjislacionit për barazi gjinore, mungesa e mekanizmave për zbatim, trajtimi i pjesshëm dhe qasja e fragmentuar, nuk po arrijnë të prodhojnë rezultate të qëndrueshme;
- Legjislacioni nxjerr disa detyra dhe obligime për komunat në këto segmente, megjithatë ndërthurja e politikave, proceseve dhe financimeve e kombinuar edhe me nivelin e ulët të kapaciteteve si dhe mungesën e praktikave të qëndrueshme, po e pengon zhvillimin koheziv;
- Përfaqësimi i grave në pozita vendimmarrëse/ekzekutive mbetet i ulët, në veçanti tek emërimet politike, por megjithatë mund konsiderohet progres në numrin e grave që kanë marrë mandat përtej kuotës gjinore 30 (%); Është evidente se asnjë person, apo grua me aftësi të kufizuara, nuk është emëruar/ekzekutiv apo nuk ka marr mandat në Kuvendin Komunal;
- Në fushën e edukimit, ekziston një nivel i përkrahjes, por që mbetet i pa strukturuar mjaftueshëm për të prodhuar rezultate të qëndrueshme sa i përket barazisë gjinore;
- Në fushën socio-ekonomike, paraqiten sfida të theksuara, në veçanti tek mungesa e politikave, financimeve dhe programeve të veçanta për përkrahje. Më rënduese bëhet gjendja, tek gratë me nevoja të veçanta dhe gratë që përkujdesen për kategoritë e cenuara;
- Tek Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ), komuna ka përmbushur obligimin për hartuar dhe paraqitur shtojcën e BPGJ-së, megjithatë numrat e paraqitur nuk korrespondojnë me mostrat e audituara, tek subvencionet;
- Ndërkaq, sa i përket ndikimit të Covid – 19, tek barazia gjinore, mund të konstatohet se është thelluar edhe më shumë hendeku i pabarazisë; komuna nuk ka hartuar një program apo mbështetje të veçantë financiare;
- Sa i përket nivelit të informimit, pjesëmarrjes dhe konsultimit, të dhënat e kryqëzuara tregojnë se ekzistojnë probleme dhe pengesa të theksuara në këto fusha, por që vullneti i deklaruar për t’u informuar, marrë pjesë dhe kontribuar në konsultime mbetet i lartë;
- Tek politikat dhe mekanizmat komunalë karshi barazisë gjinore, konstatohet se kryesisht ekziston një trajtim formal ligjor, por që nuk është arritur deri tek një qasje e integruar e trajtimit të barazisë gjinore, nisur nga strategjitë, politikat zhvillimore, rregullativa, financimet e deri tek shërbimet administrative dhe publike komunale;
- Reflektohen vullneti dhe përpjekjet nga gratë në lidhshërinë komunal, në veçanti nënkryetarja dhe mekanizmat si Zyra për Barazi Gjinore për të adresuar problemet;
- Iniciativa e Grave në Kuvendin Komunal, me mbështetjen e Organizatës Sundimi i Demokracisë në Kosovë, për themelimin dhe konsolidimin e Grupit të Grave Këshilltare, ka nisur të prodhojë efektet e para, në veçanti në procesin e konsultimit për hartimin Kornizës Afat-Mesme (2022-2025) dhe Buxhetit Komunal për vitin 2023;

## 7. Rekomandime:

Në mënyrë që të krijohen mundësi të kohezionit shoqëror nga poshtë-lartë, të bëhen përpjekje pro aktive në forcimin e mekanizmit të pjesëmarrjes në politikbërje dhe vendimmarrje duke:

- i. Rritur planifikimin e integruar i politikave dhe financimit; si dhe
- ii. Forcimi i mekanizmit të pjesëmarrjes në politikbërje dhe vendimmarrje;
- iii. Forcimin e mekanizmave lokal, për barazi gjinore;
- iv. Rritja e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe besimit të publikut për hartimin e akteve në Komunë;

### **Planifikimi i integruar i politikave dhe financimit në fokus barazinë gjinore;**

- o Të hartohet strategjia/programit komunal për barazi gjinore;
- o Të hartohet plani i integruar për barazi gjinore;
- o Të hartohet kalendari i integruar për vendimmarrje;  
Buxheti sistematik sipas praktikave më të mira të BPGJ;
- o Të alokohet buxhet i mjaftueshëm për kryerjen e vlerësimit ex ante dhe ex post të ndikimit gjinor për të informuar të gjitha politikën, veprimet, dhe buxhetet sipas Ligjit për Barazinë Gjinore.

### **Forcimi i mekanizmit të pjesëmarrjes në politik bërje dhe vendimmarrje;**

- o Të sigurohet barazia në trupat e Kuvendit dhe Këshillat Lokalë sipas Ligjit për Barazi Gjinore;
- o Të përfshihet zyrtari/ja për barazi gjinore në komunë dhe organizatat e shoqërisë civile të grave në organizimin e konsultimeve publike rreth buxhetit, ashtu siç obligohet nga Ligji 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe të angazhohen më shumë gra në të gjitha proceset buxhetore;

### **Forcimi i mekanizmave lokalë, për barazi gjinore**

- o Të organizohen seminare të aftësimit dhe/ose asistencës teknike në punë për zyrtarët komunalë për çështje gjinore që të shpërndajnë dhe diskutojnë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, me fokus në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor; dhe formulojnë politikën lokale dhe iniciativë për projekte në mbështetje të barazisë gjinore.
- o Asistencë teknike për të mbështetur bashkëpunimin ndërmjet zyrtarëve gjinorë komunalë dhe organizatave të rëndësishme të shoqërisë civile.
- o Të alokohet buxhet për trajnimin dhe mentorimin e zyrtarëve dhe për ngritjen e kapaciteteve të tyre lidhur me integrimin e politikave gjinore në politika publike në nivel lokal.
- o Në kuadër të Komiteteve Konsultative të formohet një komitet i veçantë për çështje gjinore, që do të mundësonte monitorimin e politikave lokale për barazi gjinore

### **Rritja e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe besimit të publikut për hartimin e akteve në Komunë;**

- o Ngritjen e vetëdijes për mbrojtjen e të drejtave të kategorive të veçanta si fëmijët, gratë, me aftësi të kufizuara, gratë në fshatra dhe gratë e cenuara të cilat në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët socialë do të kenë në qendër të vëmendjes problematikat e këtyre grupeve;
- o Të parashihet nga buxheti i Drejtorisë së Arsimit në nivel lokal që mësuesit/et e niveleve të Arsimit të Mesëm të Ulët dhe atij të Mesëm të Lartë të trajnohen për dhe mbi ligjërimin e ndjeshëm gjinor me qëllim të zvogëlimit të pabarazive gjinore, të transformojnë rolet gjinore dhe normat ekzistuese gjinore mbi marrëdhëniet e pushtetit.

**Sundimi i Demokracisë në Kosovë**  
Pjesëmarrja e Grave në Politik bërje